



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE**

**PROCESVERBAL
KOMITETI SEKTORIAL I MIKPRITJES DHE TURIZMIT**

1. Mirëseardhja, fjala hapëse dhe prezantimi i agjendës së aktivitetit

Takimi u hap nga zv. ministrja e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, **znj. Olta Manjani** së bashku me Kryetarin e KS, **z. Rrahman Kasa**, të cilët falenderuan të pranishmit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e vazhdueshëm për t'iu bashkuar takimeve. Në fjalën e saj hapëse, **znj. Manjani** tha se, sektori i Mikpritjes dhe Turizmit po ecën me ritme shumë të shpejta për shkak të zhvillimit që ka marrë dhe se tashmë problemi është a do të mund t'i ndjekim këto ritme. Sfida më e madhe ngelet vlerësimi i mangësive që mund të ketë jo vetëm në këtë sektor por, edhe në sektorët e tjerë. Gjithashtu, problematika më e madhe është gjetja e forcës puntore për të siguruar shërbim cilësor në këtë fushë. Ministria po punon për sigurimin e marrëveshjeve që do të mundësojë forcë punëtore por, duhet që bizneset të jenë të gatshme të ofrojnë kontratë pune një vjeçare.

Z. Kasa, ndërhyri duke thënë se bizneset nuk e kanë problem të ofrojnë kontrata një vjeçare në mënyrë që të sigurojnë stabilitet të forcës puntore, por kjo forcë puntore duhet të jetë e përgatitur, me eksperiencë, e angazhuar dhe e përgjegjshme. **Znj. Manjani** shpjegoi se, për sa kohë ata do jenë të punësuar me kontratë do jenë të përgjegjshëm dhe bizneset mund të zgjedhin punonjës me kualifikimin që atyre ju nevojitet. Ministria do të hyjë në negociata për të lehtësuar procedurat dhe kostot për marrjen e vizave.

2. Prezantimi i Studimit të Nevojave të Aftësive (SNA) dhe gjetjet e këtij studimi

Në vijim, fjalën e mori **znj. Linda Rama** për të prezantuar të pranishmit me rezultatet e gjetjeve nga Studimi i Nevojave për Aftësi (SNA) në fushën e mikpritjes dhe turizmit. Ajo vuri në dukje se aktualisht turizmi zë vendin e dytë për sa i përket peshës në ekonomi, pas bujqësisë dhe pas disa vitesh me këtë ritëm mund të jetë në vendin e parë. Shumë të rëndësishme në këtë drejtim janë investimet strategjike, por ato nuk janë kthyer ende si kontribute ekonomike dhe duhet të punohet më shumë në këtë drejtim. Një moment tjetër i rëndësishëm janë zhvillimet infrastrukturore që lidhet drejtpërdrejtë me turizmin. Në jug aeroporti i Vlorës do të sjellë një zhvillim tjetër, e po kështu dhe tuneli i Llogarasë, që do të kenë një impakt direkt në zhvillimin e zonës.

Znj. Rama theksoi se momentalisht në Shqipëri dy janë qëllimet kryesore: të promovojmë turizmin elitare dhe të kemi një turizëm të qëndrueshëm. Turizmi elitare i cili mbështetet tek investimet strategjike kërkon kushte të caktuara. Rezultatet e studimit japin një indikacion shumë të qartë se sa serioz jemi për të pasur këtë ambicje.

Studimi i nevojave për aftësi është bërë në bazë të ndarjes së zonave në tre pjesë: Tirana, zonat bregdetare dhe zonat e tjera. Në vijim, **znj. Rama** filloi të prezantonte gjetjet që rezultuan nga studimi. Kështu rezultoi se:

- Kompanitë e mëdha janë shumë pak momentalisht dhe ato janë shumë të rëndësishme për zhvillimin në të ardhmen.
- Rritja e pagës minimale ka ndikuar drejtpërsëdrejti në rritjen e produktivitetit, por ama në sektorin e turizmit ende nuk kemi një absorbim të teknologjisë, si në sektorët e tjerë.
- Në Tiranë kemi numrin më të lartë të të punësuarve, 46% prej tyre, më pas vjen zona bregdetare dhe në fund zonat e tjera.
- Pjesa më e madhe e të punësuarve janë në akomodim.
- Kompanitë investuese janë kompani shqiptare, ndërsa të huajt tek ne janë si menaxhment dhe jo si pronarë.
- Turizmi është ende i dominuar nga burrat dhe pse në krahasim me vitet përpara 2017, prezenca e gruas është rritur.
- 41% e sektorit dominohet nga të rinjtë.
- 84% e bizneseve kanë të regjistruar si punonjës pronarin dhe familjarët. Këta individë duke punuar në kompaninë e vet e kanë të vështirë të shpëputen për tu trajnuar për digjitalizimin.
- Punësimi i të huajve momentalisht zë vetëm 1% të totalit, pra një shifër e pakonsiderueshme.
- Aktualisht biznesi duke qenë në një krizë për fuqi punëtore nuk po kërkon më punëtorë të kualifikuar por vetëm fuqi punëtore.
- Duhet të punohet fort në drejtim të kulturës së mikpritjes në turizëm, duke e bërë atë ADN e turizmit tonë.
- Bizneset po përfitojnë të ardhura nga shfrytëzimi i bukurive natyrore që Shqipëria zotëron por, nuk po investon mjaftueshëm për përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe kjo është thelbësore për turizmin elitare.
- Nga studimi rezultoi se ka një mungesë të dukshme të aftësive të buta të forcës punëtore.
- Tirana rezulton se ka një mungesë aftësie më të madhe për arsyen se në zonat e tjera shiten më shumë bukuritë natyrore sesa shërbimi, ndërsa në Tiranë çdo gjë lidhet me cilësinë e shërbimit.
- Profesionet që kanë mungesën më të madhe të aftësive janë kamarierët (të punësuarit me nr. më të madh në sektor), banakierët, sanitarët dhe ndihmësit. Sanitarët dhe ndihmësit janë një problem i madh aktualisht për gjithë sektorin, edhe më shumë se shefat e kuzhinës.
- Profesionet që kanë një mungesë më të madhe të fuqisë punëtore në treg janë: kamarierët, banakierët, sanitarët.

- Profesionistët “Receptionist”, ndryshe nga një studim i 2017 që rezultonte si profesion me shumë mangësi të fuqisë punëtore, sot rezulton jo shumë problematik dhe kjo falë ndërhyrjes së shkollave profesionale që prej vitesh tashmë e ofrojnë si profil.
- 12 muajt e fundit të vitit vetëm 16 % e punonjësve janë trajnuar për zhvillimin e aftësive dhe kjo lidhet me lëvizshmërinë e shpeshtë të forcës punëtore, fondet për trajnim, mungesës së informacionit për ofertën arsimore të kurseve afatshkurtra etj.
- Duhet të rritet fleksibiliteti i ofertës arsimore të kurseve afatshkurtra.

3. Diskutimi mbi gjetjet e Studimit të Nevojave të Aftësive (SNA)

Në përfundim të prezantimit të SNA fjala i kaloi **znj. Ejvis Gishti**, Drejtor i Përgjithshëm në AKAFPK. Ajo falënderoi grupin e specialistëve që kishin kyer studimin, pasi studime të tilla janë shumë të vlefshme, sepse shërbejnë jo vetëm për plotësimin e nevojave të aftësive por, edhe për zhvillime të mëtejshme të sektorit. **Znj. Gishti** theksoi se, arsimi dhe formimi profesional nuk mund të operojë në mënyrë të ndarë nga zhvillimet e sektorit, për zhvillimin e ofertës dhe praktikave profesionale. Për sa kohë gjetjet janë në nivel profesional normalisht ato përkthehen në nevoja për kualifikim. Nga pikëpamja e informacionit bazë të studimit, anëtarët duhet të identifikojnë kualifikimet që duhen rishikuar apo shtuar. Po kështu, nga studimi del dhe informacioni për aftësitë e munguara brenda profesionit të caktuar.

4. Përcaktimi i agjendës për mbledhjen e ardhshme dhe fjala përmbyllëse

U vendos që anëtarëve do iu përcillej me email Studimi i Nevojave për Aftësi në mënyrë që ta shihnin me kujdes dhe për të menduar se si mund të përktheheshin rezultatet e gjetjeve në ofertë arsimore, në propozime për shtim ose rishikim të kualifikimeve aktuale qofshin ato afatgjata apo afatshkurtra. Për mbledhjen e ardhshme u përcaktua se anëtarët do të validojnë të gjitha standardet e profesioneve dhe kualifikimeve në fushën e mikpritjes dhe turizmit, që janë përgatitur gjatë 2024. Po kështu, anëtarët mund të bëjnë propozimet e tyre nisur nga gjetjet e SNA.